



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 19 – 5156 – 236/C187
14 Nr. 745/19
Dt. 16.08.2019

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Bashkim I. Mehmeti B.I. “** emri i biznesit - **D.P.Z. “Gumnishta “**emri tregtar me seli në **Vushtrri**, me **NRB e NRF: 810694895** si **Operator Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Bashkim Mehmeti**, në tekstin e mëtejme **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Shërbime të pastrimit dhe larjes së automjeteve për nevoja të A.K. - Vushtrri, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	51	5	6	2	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	7	6	2	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të pastrimit dhe larjes së automjeteve të administratës komunale dhe QKMF-re**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-19-076-236
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe fillon së zbatuari pas datës së nënshkrimit të kontratës, respektivisht nga data **16.08.2019** dhe përfundon më dt. **15.08.2022** duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mund të lejohet një mospërputhje e cila nuk mund të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.

- 1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Çmimeve, dhe në rsat të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të shërbimeve nuk duhet të lejojnë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të mallit për atë pozicion ose artikull.
- 1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës. Shërbimet do të ekzekutohen mbi bazën e Porosisë nga personi përgjegjës – kompetent i Njësisë Kërkuese të A.K., në këtë rast Menaxheri i Kontratës i A.K. dhe / ose drejtuesi i automjetit të autoritetit kontraktues ndërsa shërbimet duhen përfunduar menjëherë, në cilësi dhe përshtatshmëri sipas përshkrimit teknik.
- 2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: 8.899,00€ (tetmijetqindënëntëdhjetenëntë/00 Euro).
- 3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me sasinë respektivisht numrin e automjeteve të pastruara. Automjetet e pastruara sipas përshkrimit teknik duhen të jenë të evidentuara në Raportin – Regjistrin e automjeteve të cilat janë pastruar, ndërsa Raporti duhet të jetë i aprovuar me nënshkrim nga Menaxheri i Kontratës dhe drejtuesi i automjetit të njësisë shpenzuese përkatëse. Në raport duhet theksuar se shërbimet e porositura, nga Kontraktuesi janë përfunduar në kohë, në mënyrë cilësore dhe sasiore, duke respektuar kushtet e kontratës dhe Përshkrimin Teknik, pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 3.5 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa - Fatura e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

- 4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin :

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Bashkim Mehmeti
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	pronar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.08.2019	Data:	16.08.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit: VU644-19-5156-2-3-6apo nr. i brendshem: VU644-19-076-236Titulli: Pastrimi dhe larja e automjeteve - Ritender

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia Indikative për 36 muaj
1	Pastrimi - larja e jashtme dhe fshirja e mbrenshme	Copë	2920
2	Larja speciale e automjetit	Copë	44
3	Larja e motorit	Copë	100

Specifikimi i automjeteve për pastrim dhe larje

Nr.R	Përshkrimi i automjetit	Njësia	Sasia
1	Hyundai IX 35, 4WD 4 dyer v. prodhimit 2014, 1995 cm3, Dizel, Manual	Copë	1
2	Golf 4, VW v. prodhimit 2001 1390cm3, Benzin Manual	Copë	1
3	TOYOTA, Pickup 4 dyer, Hilux, v. prodhimit 1999, 2779 cm3, Dizel, Manual	Copë	1
4	VolksWagen, Kombi, Transporter VW, 7HC v. prodhimit 2014, 2149 cm3, Dizel, Manual	Copë	1

Numri i prokurimit: VU644-19-5156-2-3-6apo nr. i brendshem: VU644-19-076-236Titulli: Pastrimi dhe larja e automjeteve - Ritender

5	CITROEN, Kombi, Jumper v. prodhimit 2017, 2198 cm3, Dizel, Manual	Copë	1
6	CITROEN, Autoambulancë, Jumper v. prodhimit 2017, 2198 cm3, Dizel, Manual	Copë	2
7	MERCEDES, Autoambulancë, Daimler Chrysler v. prodhimit 2001, 2148 cm3, Dizel, Manual	Copë	2
8	FORD, Autoambulancë, FAC6 v. prodhimit 2011, 1968 cm3, Dizel, Manual	Copë	1
9	Volkswagen, Caddy v. prodhimit 2011 kubikazha 2000	Copë	1
10	Fiat Ducato Amutoambulancë 250 v. prodhimit. 2287.00cm3	Copë	1
11	Kamionet Gazelle next 150 HP, v. prodhimit 2018	Copë	1

Nr.	Lloji i automjetit	Njësa	Sasia
1	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
2	Toyota Rimorkio	Copë	1
3	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
4	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
5	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
6	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
7	Xhip Toyota 4x4	Copë	1
8	Suzuku Wargon R+	Copë	1
9	Sandero Dacia	Copë	1
10	Xhip Mersedec 270	Copë	1
11	Dacia Sandero	Copë	1
12	Toyota Prado	Copë	1
15	Toyota Prado	Copë	1

Numri i prokurimit: VU644-19-5156-2-3-6apo nr. i brendshem: VU644-19-076-236Titulli: Pastrimi dhe larja e automjeteve - Ritender

16	Kombi Mersedec	Copë	1
17	Pezho 508	Copë	1
18	Dacia	Copë	1
19	Dacia	Copë	1
21	Dacia	Copë	1

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është $\pm 30\%$

Pastrimi dhe larja e automjeteve duhet të bëhet me shampon dhe preparate adekuate për pastrimn dhe larjen e automjetve.

Pastrimi i automjetve duhet të kryhet me prioritet dhe pa vonesa që në momentin e arritjes së automjetit në autolarje.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat E, ku duhet ta shkruani çmimin me të gjitha detyrimet, poashtu çmimin duhet ta shkrueni me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia Indikative për 36 muaj	Çmimi për njësi DDP-€	Vlera - €
1	Pastrimi - larja e jashtme dhe fshirja e mbrenshme	Copë	2920	2.95	8,614.00
2	Larja speciale e automjetit	Copë	44	2.50	110.00
3	Larja e motorit	Copë	100	1.75	175.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM:					8,899.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	D.P.Z. "GUMNISHTA"
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Bashkim Mehmeti
NËNSHKRIMI:	
DATA:	26.07.2019
VULA:	

